

11 mars 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 04.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 11.03.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET dënim me të holla në vlerë prej 300.00 EUR ndaj klubit KB GO+ Peja, për shkelje të lehtë disiplinore sipas Nenit 46(2)(c) të Rregullores Disiplinore të FBK-së, për deklarata publike që lidhen me performancën e gjyqtarëve ose ndonjë zyrtari të ndeshjes;
- II. Masa ka efekt ndalues dhe edukues, duke pasur për qëllim të parandalojë çdo deklaratë publike të ngjashme në të ardhmen që mund të cenojë rregullin, respektin dhe integritetin e garave të organizuara nga FBK;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe duhet të paguhet nga KB GO+ Peja brenda afatit të përcaktuar nga administrata e FBK-së.

A R S Y E T I M

Më datë 04.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën nga Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës (SHGJFBK) për inicim të procedurës disiplinore ndaj KB GO+ Peja (tash e tutje “Kërkesa”), lidhur me deklaratën/letren publike për Shoqatën e Gjyqtarëve, e publikuar në rrjetet sociale të klubit pas ndeshjes së zhvilluar mes KB Bashkimi dhe KB GO+ Peja.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, më datë 09.03.2026, KD ka mbajtur takimin e parë shqyrtues për vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të ngjarjes. Në kuadër të këtij takimi, KD është informuar nga FBK se, përmes administratës së saj, ka komunikuar me klubin KB GO+ Peja lidhur me rastin, dhe klubi ka dërguar përgjigje në të cilën është shprehur lidhur me situatën e trajtuar. Ky komunikim ka qenë në dispozicion të Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim.

Në funksion të trajtimit të lëndës, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

KD ka marrë në shqyrtim deklaratën publike të KB GO+ Peja të datës 16.02.2026. Në deklaratë, klubi shpreh shqetësime për disa vendime të gjyqtarëve gjatë ndeshjes dhe për kriterin e ndarjes së drejtësisë në disa situata specifike të lojës. Klubi gjithashtu thekson se nuk kërkon të justifikojë rezultatin e ndeshjes dhe pranon përgjegjësinë për humbjen, por shpreh pakënaqësi ndaj veprimeve të gjyqtarëve dhe kërkon që FBK të marrë masa për të parandaluar përsëritjen e situatave të ngjashme.

Në vlerësimin juridik të rastit, KD ka konstatuar se dispozita përkatëse që trajton situatën në fjalë është Neni 46, paragrafi 2, pika (c) i Rregullores Disiplinore të FBK-së, i cili përcakton:

2. Shkelje të lehta në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e garave konsiderohen këto si në vijim:

[...]

(c) Deklarata publike, përfshirë ato të bëra në rrjetet sociale ose çdo mjet komunikimi, që lidhen me performancën e gjyqtarëve ose ndonjë zyrtari të ndeshjes.

KD ka konstatuar se deklarata publike e klubit KB GO+ Peja, lidhur me performancën e gjyqtarëve gjatë ndeshjes, hyn qartë në fushën e aplikimit të Nenit 46(2)(c) të Rregullores Disiplinore.

Komisioni thekson se në sportin e organizuar profesionalisht, performanca e gjyqtarëve nuk diskutohet publikisht. Çdo pakënaqësi mbi vendimet e gjyqtarëve duhet të adresohet përmes kanaleve të brendshme të FBK-së, duke respektuar procedurat e ankimimit dhe shqyrtimin institucional. Diskutimi publik i performancës së zyrtarëve mund të cenojë besueshmërinë e garës, integritetin e sportit dhe respektin për të gjithë pjesëmarrësit. Prandaj, deklaratat publike që lidhen me performancën e gjyqtarëve konsiderohen shkelje të lehta disiplinore, pavarësisht qëllimit të palës për të shprehur pakënaqësi.


Komisioni ka marrë parasysh se sipas Nenit 47, alineja 2.2 të Rregullores Disiplinore, për shkelje të lehta nga organizatat sportive mund të shqiptohet: dënim me të holla prej 300.00 EUR deri në 2,000.00 EUR ose ndalesë të prezencës së shikuesve për 1 deri në 4 ndeshje. Në marrjen e parasysh të rrethanave ndikues sipas Nenit 23, KD ka vlerësuar se masa më e lehtë, dënimi minimal

me të holla prej 300.00 EUR, është e arsyeshme dhe proporcionale. Në këtë vlerësim janë marrë parasysh fakti se deklarata ka qenë publike dhe ka përfshirë referenca ndaj individëve dhe se klubi ka pasur mundësinë për sqarim në komunikimin e bërë nga FBK.

KD thekson se masa minimale financiare transmeton një mesazh të qartë se deklaratat publike për performancën e gjyqtarëve nuk tolerohen, në të njëjtën kohë duke respektuar karakterin edukues dhe parandalues të dënimeve, dhe duke siguruar që klubet të ndjekin rrugët institucionale për shqyrtimin e pakënaqësive dhe të ruajnë respektin dhe integritetin e garës. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të ngjashme, KD do të shqiptojë masa më të rrepta, sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore.

Bazuar në të gjitha si më sipër, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 11 mars 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB GO+ Peja
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- SHGJFBK
- Komisionit të Garave
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.